



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 dhe 17 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, lidhur me nenin 5 dhe 14 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënie në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Pa luajtshme Komunale, nenin 41 pika a dhe h të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me dt.26.02.2021, pas diskutimeve lidhur me pikën e 3 të Rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e fushës së Futbollit në fshatin Korenicë , e miratoi këtë:

V e n d i m P ë r

Caktimin e lokacionit për ndërtimin e fushës së Futbollit në fshatin Korenicë .

1. Caktohet lokacioni për ndërtimin e fushës së futbollit së bashku me infrastrukturën përcjellëse në parcelat 00106-1 dhe 0097-1-2-3 Zona Kadastrale Korenicë, në pronësi të Komunës së Gjakovës.
2. Parcelat 00106-1 dhe 0097-1-2-3 Zona Kadastrale Korenicë ndahen me qëllim të ndërtimit të fushës së futbollit bashkë me infrastrukturën përcjellëse, ku investimi do të bëhet me vetëfinansim të banorëve të fshatit Korenicë .
3. Parcelat 00106-1 dhe 0097-1-2-3 mbeten në pronësi të Komunës, në të cilat i lejohet zhvillimi i aktiviteteve sportive Klubit Futbollistik “Korenica” .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

5.Vendimi iu dërgohet:

- z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Z. Anton Shala